

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 90 Prot


Tiranë, më 04, 06, 2012

VENDIM Nr. 197, dt. 04.06.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 04.06.2012, pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik për Projektin: Ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan, Loti 3, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan, Loti 3" realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Tiranë.
- II. Kryerjen e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në segmentin rrugor Tiranë – Elbasan, Loti 3, KM 26+ 535, pranë fshatit Reçan, Elbasan, sipas traktit EL-T.26 të përcaktuar gjatë vëzhgimit intensiv arkeologjik në terren.
- III. Raporti përfundimtar i gërmimeve arkeologjike të shpëtimit do të kalojë për miratim në KKA.
- IV. Gërmimet arkeologjike të shpëtimit do të kryhen nga ASHA në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike) dhe DRKK Tiranë.



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

- V. Vend depozitimi i gjetjeve arkeologjike të luajtshme do të përcaktohet nga KKA.
- VI. Autoriteti Rrugor Shqiptar duhet të njoftojë fillimin e punimeve për ndërtimin e këtij Loti, në mënyrë që ASHA dhe DRKK Tiranë të sigurojnë prezencë të vazhdueshme të ekspertëve arkeologë gjatë zbatimit të projektit.
- VII. Shpenzimet për kryerjen e gërmimeve arkeologjike të shpëtimit do të mbulohen nga investitori (ARrSH) sipas preventivit të përgatitur nga ASHA dhe IA (QSA).
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al